



FOKUS I
Albania - Kosova

Seria F
Dërguar nga Jezusi
Manual



FOKUSI – Seri F - Manuali

Dërguar nga Jezusi

Hyrje

Mirësevini në takimet e "Fokusit". Në këtë seri do të gjeni 5 tema. "FOKUSI" përdor katër shtylla për të strukturuar takimet. Çdo takim përbëhet nga disa elemente fikse, të cilat janë si më poshtë:



a. Studimi i Biblës

Së pari, ne duam të njohim Fjalën e Perëndisë duke studiuar së bashku një pjesë të Biblës. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me marrjen e sa më shumë njohurive dhe diskutimit të temave të kësaj serie, por me mënyrën se si mund t'i zbatojmë ato në jetën tonë dhe se si përshtatet kjo pjesë e Biblës me përvojat tona.



b. Lutje

Lutja është themeli i gjithë serive të Fokusit. Duke u varur tek Perëndia, ne duam të arrijmë atë që Zoti mund të bëjë në mesin tonë dhe se si Ai mund të punojë përmes nesh. Prandaj, ne duam të lutemi për bekimin e tij, ta falënderojmë dhe ta adhurojmë. Në të njëjtën kohë ne duam të ndërmjetësojmë për njerëzit dhe situatat që po kalojnë.





c. Në lëvizje

Është e rëndësishme të zbatojmë gjërat që do të mësojmë dhe zbulojmë në këto takime. Në këtë pjesë, propozohen hapa të vegjël që mund të bëjmë si një ushtrim në situatën tonë. Ndonjëherë personalisht, ndonjëherë si grup ose si kishë, ne do të inkurajojmë njëri-tjetrin që me të vërtetë ti zhvillojmë këto aktivitete duke bërë plane konkrete dhe më vonë duke pyetur njëri-tjetrin se si i kemi praktikuar.



d. Ndarja e tregimeve

Në seksionin "Ndarja e tregimeve", ju jeni të ftuar të shprehni mendimet tuaja për Zotin dhe besimin dhe t'i ndani ato me të tjerët. Për më tepër, njerëz nga vende të ndryshme do të flasin për temat në video të shkurtra. Ata përpiqen të ecin me Perëndinë në rrethana të ndryshme, por të gjithë kanë pyetje dhe situata të ngjashme si ju.

“Fokusi” është një proces shpirtëror

Ky material për grupet është pjesë e serisë “Fokusi”, e cila ka për qëllim të fillojë një proces reflektimi për të gjithë kishën, se si mund të jemi një kishë misionare me një përqendrim të përtërirë në Jezus Krishtin. Kjo seri e “Fokusit” është si një rrugëtim që ecim së bashku. Gjithsej janë gjashtë seri.

“Fokusi” është një proces mësimi i cili ka për qëllim të inkurajojë dy lëvizje:



- a. Një lëvizje në drejtim **të brendësisë**, drejt zemrës së kishës dhe drejt zemrës sonë personale. Ne do të flasim në thellësi se kush është Zoti në jetën tonë. Ne gjithashtu do të flasim për kuptimin e njohjes së Jezusit dhe të jetuarit me të. Si mund të jemi dëshmitarë besnikë në ditën e sotme? Kjo është një pyetje në radhë të parë për besimin tonë personal. Si mund ta lidhim besimin tonë në jetën tonë të përditshme: me punën, me familjen, me lagjen tonë, me miqtë tanë? Praktikisht: Si mund ta lidhim besimin tonë në vendin dhe rolin që Zoti na ka caktuar?



- b. Lëvizja e dytë ka të bëjë me një lëvizje të përtërirë drejt **të jashtmes**. Ne i hapim sytë, zemrat tona dhe jetën tonë për njerëzit përreth nesh. Sidomos për njerëzit që ende nuk e njohin Jezusin. Ne do të kërkojmë këtë lëvizje të jashtme që nga fillimi i kësaj serie “Fokusi”. Në secilin mësim do të kërkojmë sesi mund të jemi të përfshirë në mënyrë praktike dhe aktive, kështu që nuk do të jetë thjesht një reflektim dhe diskutim i pafund.

Sfondi

Qëllimi i serisë “Fokusi” është të mbështesë kishat në thirrjen e tyre misionare. Materiale të ndryshme janë zhvilluar duke dëgjuar me kujdes pyetjet e shumë të krishterëve dhe kishave.





Seria “Fokusi” nuk është vetëm një metodë, një strategji apo një program. Është para së gjithash një proces shpirtëror, një proces reflektimi, thellimi dhe ndryshimi.

Ne ndjekim **disa vlera kryesore** që shpjegojnë se çfarë është e rëndësishme në serinë “Fokusi”:

A. Kërkimi dhe përlësia

Procesi fillon duke parë me ndershmëri situatën në të cilën jemi. Shpesh ne jemi të pasigurt në lidhje me sfidën e madhe të kishës për të qenë një kishë misionare në një shoqëri laike. Sekularizmi dhe mosinteresimi për besimin nuk është vetëm diçka jashtë nesh por ndikon edhe në jetën tonë dhe zemrat tona si të krishterë. Ka shumë besimtarë që janë shumë të rregullt me pjesëmarrjen në mbledhjet e kishave, por në zemrat e tyre nuk janë shumë seriozë me besimin e tyre. Kjo mund të na bëjë të ndihemi të pasigurt dhe të përlur. Kur flasim në serinë “Fokusi” për ndryshimin, ne flasim në radhë të parë për ndryshimin në jetën tonë. Është e nevojshme që së pari të përllemi para Zotit, që të jemi të sinqertë me veten tonë, pasiguritë tona dhe pamundësitë tona.

Ne mund t'i kapërcejmë këto probleme vetëm duke kuptuar se sa jemi të varur tek hiri i Zotit. *“Në qoftë se populli im, i cili thirret me emrin tim, përlulet, lutet, kërkon fytyrën time dhe kthehet prapa nga rrugët e këqija, unë do ta dëgjoj nga qielli, do t'i fal mëkatën e tij dhe do ta shëroj vendin e tij”.* (2 Kronikave 7:14)



B. Dëshira dhe pritja

Ne nuk duam të përqendrohemi në situatën aktuale ose ta pranojmë atë. Ne besojmë se dëshira për ndryshim dhe përtëritje vendoset në zemrat tona nga Fryma e Zotit. Ne besojmë në thirrjen e lartë që Zoti ka për kishën e tij. Kur dëshira ndërlihet me besimin, lind një qëndrim i pritjes. Ne nuk e presim atë nga angazhimi ynë, nga njohuritë ose veprimtaritë tona, por ne e presim atë vetëm nga Ai që na dërgon me fjalët: *"Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë ... dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës"*. (Mateu 28: 19,20). Fillon me të jetuarit në praninë e tij dhe besimi se asgjë nuk është e pamundur për Të.

C. Përbushja dhe rinovimi

Në Dhiatën e Re misioni nuk është vetëm një përkushtim, por edhe një premtim: *"Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut"* (Veprat 1: 8) Ne besojmë se dëshmia jonë do të sjellë fryte dhe se ndryshimi i vërtetë është i mundur vetëm përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë, i cili na mbush dhe rinovon jetën tonë nga brenda. Në serinë "Fokusi" ne duam të kemi shumë kohë për lutje dhe duam të përqendrohemi në atë që vetë Zoti dëshiron të bëjë në ne dhe përmes nesh përmes Frymës së Tij.

D. Thellimi dhe zgjerimi

Kur ne mendojmë për ungjillëzimin dhe një kishë misionare planifikohet shpejt për modelet, metodat dhe aktivitetet e reja. Por ne besojmë se së pari duhet thellimi shpirtëror. Bëhet fjalë për zemrën tonë, besimin tonë, jetën tonë. Kush është Jezus Krishti për ne dhe si e jetojmë jetën tonë me Të? A jetojmë sipas mënyrës sonë gjatë javës, apo vërtetë përqipemi të imitojmë Krishtin në jetën tonë?



Përveç këtij thellimi shpirtëror, zgjerimi është gjithashtu i nevojshëm, në mënyrë që diskutimi për dishepullizimin dhe mënyrën e jetesës misionare të mos kufizohet në një grup të vogël anëtarësh të kishës, por që e gjithë kisha të përfshihet.

Pika të vëmendjes për një bisedë të mirë

Të gjithë marrin pjesë dhe mund të flasin

Një bisedë e mirë fillon me të dëgjuarit. Mundohuni së bashku të siguroheni që të gjithë në grup mund të flasin dhe që të gjithë të dëgjoen.

Roli i drejtuesit të bisedës

Drejtuesi i bisedës nuk është eksperti i cili duhet t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve ose të përcaktojë nëse përgjigjet janë të drejta ose të gabuara. Ai / ajo është atje për të bërë bisedën dhe nëse është e nevojshme, për ta thelluar atë. Ai / ajo gjithashtu monitoron kohën dhe ndihmon grupin të vazhdojë diskutimin.

Pyetje personale

Shumë nga pyetjet në këtë material nuk janë pyetje diturie, të cilave mund t'i jepet vetëm një përgjigje e saktë. Shumica e pyetjeve janë krijuar për të filluar një bisedë se çfarë do të thotë pasazhi i i Biblës në aspektin tonë personal. Pyetjet na ndihmojnë të zbatojmë Biblën në jetën tonë. Ne mund të ndihmojmë dhe inkurajojmë njëri-tjetrin në këtë.



Dëgjimi i Zotit dhe i njëri-tjetrit

Përveçse duam të dëgjojmë njëri-tjetrin, ne natyrisht duam të dëgjojmë atë që Zoti dëshiron të na tregojë përmes Biblës dhe përmes Frymës të Tij. Për këtë arsye, është planifikuar të ketë sa më shumë kohë për lutje. Le



të marrim kohë të mjaftueshme për t'u lutur gjatë mbledhjes.

Në lëvizje

Pjesa "Në lëvizje" është një pjesë e rëndësishme sepse është si një urë lidhëse midis asaj që diskutojmë në Bibël dhe praktikës së jetës sonë të përditshme. Jemi të inkurajuar të marrim hapa konkret. Ne mund të ndihmojmë njëri-tjetrin duke bërë plane sa më konkrete të jetë e mundur. Mos pyesni vetëm njëri-tjetrin se çfarë dëshironi të bëni, por edhe konkretisht: Ku, me kë, kur dhe si?

Ndarja e tregimeve

"Ndarja e tregimeve" është krijuar për të zbuluar se si Zoti i angazhon njerëzit dhe punon përmes tyre. Ne e bëjmë këtë duke dëgjuar tregimet e të krishterëve të tjerë, të cilët mund të jetojnë afër ose larg. Por edhe duke i thënë njëri-tjetrit se çfarë përvojash kemi me kryerjen e ushtrimeve nga seksioni "Në lëvizje". Është e rëndësishme që të dëgjojmë tregimin e personit tjetër, pa dhënë menjëherë komente ose këshilla të padëshiruara.

Kthehu te thelbi

Qëllimi i këtij materiali diskutimi është që të bashkohemi në një fokus të ri. Një fokus të ri në Jezus Krishtin. Mundohuni të ktheheni përsëri në këtë gjë thelbësore, kur gjatë bisedës humbisni në diskutime rreth çështjeve dytësore.

Konfidencialiteti

Jini të kujdesshëm me informacionin që dëgjoni nga njëri-tjetri. Sa më personale të bëhet biseda, aq më e vlefshme është. Por nëse thoni gjërat personale, kjo ju bën gjithashtu të prekshëm. Prandaj, është e



nevojshme një atmosferë e sigurt në të cilën të gjithë vlerësohen dhe besimi nuk çënohet.

Atmosferë e mirë

Krijoni një atmosferë të mirë dhe të rehatshme. Bisedat duhet të zhvillohen në kishën e Krishtit. Ne e dimë se jo të gjithë njerëzit janë njësoj por Perëndia mund të punojë në njerëz të ndryshëm në mënyra shumë të ndryshme. Mahnituni me atë që ju jep Zoti. Ne e kuptojmë se në bisedat tona dhe detyrat konkrete që bëjmë, ne jemi plotësisht të varur nga Fryma e Zotit. Ai madje punon përmes pafuqisë sonë.

Lutje

Lutja është një pjesë e rëndësishme e “Fokusit”. Ne besojmë se një seri e “Fokusit” ka vetëm kuptim nëse ajo zhvillohet me lutje. A doni të luteni për procesin e “Fokusit” në kishën tuaj? Më poshtë janë disa sygjerime lutjeje që mund të përdorni në grup ose në shtëpi.

Përrulje

Në procesin e “Fokusit” është e rëndësishme të kërkonti falje. Ne duhet të jemi të sigurtë me Perëndinë dhe t'i tregojmë atij për vaktësinë tonë, ndrojtjen tonë, paaftësinë dhe fajin tonë. Gjithë këto gjera janë në zemrat tona. Përmendoni këtë në lutje dhe kërkojini Zotit falje.

Lutje

- Lutuni për programin “Fokusi” në kishë. Kërkojini Zotit të bekojë procesin. Mendoni për atë që dëshironi për procesin e “Fokusit”. Çfarë doni të ndodhë me veten tuaj? Po me kishën? Shprehni këto mendime tek Zoti.



- Lutuni për udhëheqësin e kishës dhe udhëheqësit e tjerë dhe rolin e tyre në proces.
- Lutuni për pjesëmarrësit në serinë “Fokusi”.
- Lutuni që Zoti të bekojë bisedat dhe t'i ndihmojë pjesëmarrësit të zbatojnë atë që mësojnë.
- Lutuni për anëtarët e Kishës dhe kërkoni nga Zoti që të ketë një takim të ri me Jezusin.
- Lutuni për njerëzit që takoni në jetën e përditshme që nuk e njohin Zotin akoma. Lutuni që ata të njihen me Jezus Krishtin.

Falënderime

- Falënderoni Zotin për Atë që është dhe për çfarë Ai ka bërë për ne.
- Falënderoni Zotin për këtë seri të “Fokusit” në kishën tuaj.
- Falënderoni Zotin për kishën në të cilën jeni anëtarë.



Tema e parë:

Duke sjellë lajme të mira



1. **Mirëpresni** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.

2. **Filloni me Hyrjen në faqen 2**

Tema e këtij libri është: Jezusi është “Dërguar nga Jezusi”. Lexoni hyrjen dhe shpjegoni pesë shenjat e misionit. Çdo takim do të fokusohet në një temë. Pra, këtë herë tema është: "Të shpallim lajmin e mirë".

Pesë shenjat e misionit:



Shpallja e lajmit të mirë



Pagëzimi dhe rritja e besimtarëve të rinj



Përgjigje ndaj nevojës përmes shërbimit



Ndryshimi i strukturave të padrejta



Kujdesi për krijimin



3. **Ndarja e tregimeve, faqe 3**

Lexoni tekstin në faqen 3 dhe kërkojuni dy njerëzve të përmbledhin mesazhin e ungjillit në 3 ose 4 fjali. Është e vështirë apo jo?



4. **Lexoni Biblën, Isaia 52:1-7 dhe Marku 1:14-15 (faqet 3, 4)**





5. Diskutoni pyetjen 1

- a. Ungjilli është lajmi i mirë për njerëzit e humbur. Perëndia erdhi në këtë tokë në Jezusin për të shpëtuar njerëzit nga mosbindja. Zoti mbretëron. Ky lajm i mirë mund t'u transmetohet të gjithëve.
- b. Bibla na thotë se njerëzit janë të pabindur dhe se kjo prish marrëdhëniet midis njeriut dhe Perëndisë. Por Zoti ka premtuar se një zgjidhje do të vijë. Një Shpëtimtar do të vijë për të shpëtuar njerëzit nga mëkati dhe mosbindja. Ky Shpëtimtar erdhi 2000 vjet më parë. Emri i tij ishte Jezus. Ardhja e tij u përgatit nga Gjon Pagëzori.

6. Lexoni faqen 11 Isiaha thotë: Zoti është mbret!”

Isaia inkurajon popullin e tij në mërgim. Zoti është mbret, edhe kur rrethanat janë të vështira. Kur mendojmë për "mbretërinë" në Bibël, nuk duhet së pari të mendojmë për një zonë ose një vend. Bëhet fjalë për atë që është sundimtar. Në fakt, Zoti është mbret kudo, sepse Ai është Krijuesi i qiellit dhe i tokës.

Nga njëra anë, mbretëria e Perëndisë është tashmë e pranishme në këtë tokë, por nga ana tjetër, është diçka që duhet të vijë gjithnjë e më shumë.



7. Diskutoni pyetjen 2

- a. Ftojini njerëzit të tregojnë diçka rreth mënyrës se si mund ta shohin ose ta përjetojnë Perëndinë dhe mbretërinë e Tij. (paqe, pushim, shërim, inkurajim, etj.)
- b. Gjithçka do të jetë perfekte, jo më lot, pa konflikte, etj. Si e imagjinojnë ata ditën kur Jezusi të kthehet?



8. Lexoni faqen 6 “Marku”

Ardhja e Jezusit ndryshon gjithçka. Ai është lajmi i vërtetë i mirë. Më i madh se çdo sundimtar tjetër. Kjo kërkon një mënyrë të re jetese nga ne.



9. Diskutoni pyetjen 3 (Nëse ka kohë të mjaftueshme, kjo pyetje mund të diskutohet në grupe të vogla)

Zoti është i fuqishëm dhe megjithatë ka kaq shumë dhimbje, sëmundje dhe vuajtje. Kjo është një nga pyetjet më të vështira për shumë jobesimtarë. Lërimi njerëzit t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. A vlen edhe për ta kjo pyetje? Mund të besojmë se fitorja u fitua nga Jezusi. Djalli është mundur. Por derisa Jezusi të kthehet, ne ende jetojmë në një botë që është e papërsosur. Ndonjëherë e krahasoj me një pulë të therur. Edhe kur koka e tij është e hequr, trupi ende lëviz për një kohë. Madje ndodh që pula ende mund të ecë disa hapa pa kokën e saj. Pra, duket se është ende gjallë. Por kjo është vetëm një pamje. Ai është therur! Pas një kohe të shkurtër, do të përfundojë përgjithmonë. Satani ndonjëherë mund të bëjë të gjitha llojet e gjërave të tmerrshme, por ai është mundur nga Jezusi në kryq. Vetëm pak kohë dhe fuqia e Satanit do të thyhet përgjithmonë.

10. Lexoni faqen 7 “Fitore”

Ky është një shembull tjetër për të kuptuar më mirë se mbretëria e Perëndisë tashmë ka ardhur nga njëra anë, por nga ana tjetër ajo ende po vjen.



11. Lexoni faqen 8 “Konvertim”.

Mbretëria e re kërkon që ne të shikojmë me sy të ndryshëm, të kthehemi. Ne besojmë se ajo që filloi e vogël përfundimisht do të shndërrohet në diçka të madhe.

**12. Diskutoni pyetjen 4, faqe 8**

- a. Konvertim do të thotë të kthehesh. Jeta juaj ndryshon drejtim. Ti kthen shpinën ku ishe drejtuar më parë.
- b. Lërimi njerëzit të tregojnë se si kanë përjetuar një ndryshim në jetën e tyre. Ku ishin drejtuar ata më parë dhe tani cili është qëllimi i tyre në jetë?

13. Lexoni faqen 9 “Shpallni lajmin e mirë!”

Për shkak se mbretëria është afuar, është e rëndësishme t'u tregojmë të tjerëve. Më pas mund të përgatiten. Jezusi do të kthehet. Ata që besojnë në Të do të gëzohen. Ata që nuk besojnë do të gjykojnë.

**14. Diskutoni pyetjen 5**

- a. Këtu mund të thuash se askush nuk e di me siguri ditën e kthimit të JESUSIT. Ai do të vijë si një hajdut natën. Kushdo që parashikon ditën e saktë është një mësues i rremë, thotë Bibla. Megjithatë, mund të shohim shenja se ardhja e Jezusit po afrohet, si tërmetet, zitë e bukës dhe luftërat. Si do të jetë saktësisht ardhja e tij përshkruhet në kapitujt e fundit të Mateut, librin e



Zbulesave dhe në një numër letrash të Palit. Ka mendime të ndryshme, për shembull, për mijëvjeçarin, rrëmbimin e besimtarëve, etj. Gjëja më e rëndësishme nga të gjitha nuk është që ne të përpiqemi të zgjidhim të gjitha detajet, por të jemi të përgatitur për ardhjen e Jezusit, në mënyrë që ne nuk vonojmë (ashtu si me 5 vajzat nga shëmbëlltyra e 10 shoqërueseve).

- b. Lëroni njerëzit të përgjigjen këtu nëse flasin me jobesimtarët për këto tema. A janë këto tema të përshtatshme apo jo për të diskutuar me jo të krishterët? Çfarë mendojnë njerëzit për këtë?



15. Ndarja e tregimeve

Lexoni tekstin e “Ndarja e tregimeve” dhe shikoni videon. Shikoni lidhjen <https://youtu.be/Lg4RrLvPpUE> ose skanoni kodin QR.

Më pas diskutojmë pyetjet.



- a. Ata e shohin mbretërinë e Perëndisë si diçka që tashmë ka filluar pjesërisht. Mund të shihet në gjërat e vogla, si vëmendja ndaj njëri-tjetrit, harmonia, kujdesi, dashuria etj. Ata duan të tregojnë se kujdesen për njerëzit e tjerë.



- b. Lërimi njerëzit të përgjigjen. A ka ndonjë shembull në video që i shtyn ata të mendojnë dhe që mund të dëshirojnë ta bëjnë vetë?



14. Lexoni “Në lëvizje”.

- A do të donin ata të shprehnin përmbledhjen e shkurtër të ungjillit tani siç bënë në fillim të mbledhjes? Apo ka ndryshuar diçka?
- Lërimi njerëzit të mendojnë nëse ndoshta mund t'i shpjegojnë një jo të krishteri javën e ardhshme se cili është thelbi i ungjillit. Dhe më pas pyesni atë person nëse ai/ajo e kupton.



15. Mbylleni takimin me një lutje

Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkoni njerit prej pjesëmarrësve që të lutet



Tema e dytë: Të jesh dishepull dhe të bësh dishepuj

Të jesh dishepull dhe të bësh dishepuj



1. **Mirëpresni** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Ndarja e tregimeve**
Cili ishte reagimi i jo të krishterëve kur pjesëmarrësit u shpjeguan shkurtimisht se për çfarë është besimi i krishterë? Le të përgjigjen disa.

3. Lexoni faqen 12 “Hyrje”

Sot fokusi është tek shenja e dytë: “Pagëzimi dhe rritja e besimtarëve të rinj”.



Shpallja e lajmit të mirë



Pagëzimi dhe rritja e besimtarëve të rinj



Përgjigje ndaj nevojës përmes shërbimit



Ndryshimi i strukturave të padrejta



Kujdesi për krijimin



4. Lexoni Biblën, Gjoni 15:2-8 dhe Mateu 28:16-20





5. Diskutoni pyetjen 1

- a. Të gjithë ata që duan ta ndjekin Jezusin në jetën e tyre të përditshme janë dishepujt e sotëm. Kjo do të thotë që ndonjëherë edhe ju duhet të hiqni dorë nga gjërat, ashtu si dishepujt e parë.
- b. Është e rëndësishme që si ndjekës i Jezusit
 - të jesh i pastër
 - të qëndrosh në Të (për të dhene fryt)
 - të shkosh
 - të besh dishepuj
 - të pagëzosh besimtarët e rinj
 - të mësosh besimtarët e rinj të ndjekin gjërat që Ai u ka urdhëruar

6. Lexoni “Të jesh dishepull” dhe “Qëndroni të lidhur”



7. **Diskutoni pyetjen 2** (Kjo është një pyetje e mirë për të diskutuar në grupe të vogla)
 - a. Duke u lutur, duke lexuar Biblën, duke shkuar në mbledhje, duke dëgjuar radio të krishterë, duke biseduar me të krishterë të tjerë, etj.
 - b. Për shembull, duke mos i bërë rregullisht pikat e mësipërme. Indiferenca, dembelizmi, të qenit shumë i zënë me gjëra të tjera etj.
 - c. Ju mund të ktheheni te Jezusi çdo ditë nëse i luteni atij dhe e ndiqni seriozisht Atë çdo ditë në jetën tuaj të përditshme.



8. Ndarja e tregimeve

Shikoni videon me Marieke. Ajo jeton si misionare në Azinë Juglindore. Shikoni lidhjen <https://youtu.be/8hXLdfvw7LO> ose skanoni kodin QR.



Më pas diskutoni pyetjet.



- a. Ajo zgjedh me vetëdije të planifikojë kohë për leximin e Biblës dhe lutjen. Edhe pse ajo është e zënë. Ajo izolohet dhe kalon një kohë të qetë me Zotin.
- b. Lëroni njerëzit të përgjigjen për atë që i prek në këtë histori.



9. Lexoni “Beni dishepuj” në faqen 16

Këtu ne reflektojmë mbi "Misionin e Madh". Jezusi dëshiron që ne të përfshijmë njerëz të rinj. Sa më shumë njerëz që të jetë e mundur duhet të dëgjojnë lajmin e mirë.



10. Diskutoni pyetjen 3

Kjo pyetje është e përshtatshme për diskutime në grupe të vogla nëse e lejon koha.

- a. Ftoni njerëzit të flasin për përvojat e tyre.
- b. Si i ndihmojnë ata të tjerët të rriten?
- c. Së paku, një besimtar i ri duhet të njohë pikat thelbësore të besimit të krishterë, si krijimi, rënia, ardhja e Jezusit, një sërë shëmbëlltyrash, vdekja dhe ringjallja e Jezusit, derdhja e Frymës së Shenjtë, historia. të kishës së parë etj.



11. Lexoni “Në lidhje me Jezusin” në faqen 17



12. Në lëvizje

Për çdo ditë të javës ka një thenie që ka të bëjë me "Unë jam".

Kërkojuni atyre të mendojnë për një person specifik për të cilin mund të luteni gjatë javës së ardhshme. Lexoni këto pastaj së bashku.



13. Mbylleni takimin me një lutje. Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonit njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



Tema e tretë: Besoni me zemër dhe me vepra

Besoni me zemër dhe me vepra



1. **Mirëprisni** njerëzit dhe filloni me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Ndarja e tregimeve**

Bëjini njerëzit t'i përgjigjen pyetjes nëse janë lutur për 1 person të caktuar gjatë javës së kaluar që ai/ajo të rritet në besim.



Shpallja e lajmit të mirë



Pagëzimi dhe rritja e besimtarëve të rinj



Përgjigje ndaj nevojës përmes shërbimit



Ndryshimi i strukturave të padrejta



Kujdesi për krijimin



3. **Lexoni Hyrje, faqe 21**

Sot fokusi është tek shenja e tretë: “Përgjigje ndaj nevojës përmes shërbimit”



4. **Lexoni Biblën, Jakobi 2:1-9 dhe 14-17**



5. Lexoni “Bërësit e fjalës, faqe 22



6. Diskutoni pyetjen 1

- Jakobi thotë se besimi pa vepra është i pakuptimtë. Është i vdekur në vetvete.
- Ftojini njerëzit të përmendin se cili shembull u pëlqen dhe është i rëndësishëm sot. p.sh. njerëzit pa veshje (shtëpi), ushqim ose situata të tjera.

7. Lexoni “Të jetosh sipas ligjit mbretëror”, faqe 23

Jakobi është një libër praktik. Është ndoshta libri më i vjetër në Bibël. Besimi i vërtetë shfaqet në mënyrën se si e trajtoni të afërmin tuaj.



8. Ndarja e tregimeve

Lexoni deklaratat e Nënë Terezës dhe bëni që të gjithë të zgjedhin 1 ose 2 që rezonojnë me to. Pastaj pyesni njerëzit pse i zgjodhën ato deklaratat. Kjo pyetje mund të diskutohet edhe në grupe të vogla.



9. Lexoni “Mos bëni asnjë dallim, faqe 25



10. Lexoni “Besoni me të vërtetë”, faqe 26





11. Diskutoni pyetjen 2, faqe 26

- Le të japin shembuj. P.sh. të kesh kohë për dikë tjetër, të ndihmoh dikë që është i vetmuar, të ndihmoh dikë që nuk ka ushqim, të lutesh për dikë tjetër etj.
- Ftojini të flasini për mënyrën se si kisha është e përfshirë në ndihmën praktike. P.sh. për të moshuarit, invalidët, njerëzit e lagjes, fëmijët?
- A njohin ata njerëz që më vonë u bënë të krishterë nëpërmjet ndihmës praktike? Ndoshta kjo vlen për një nga pjesëmarrësit.



12. Në lëvizje

Shikoni një video për Bankën e Ushqimit. Shikoni lidhjen <https://youtu.be/rEB69t5rD6M> ose skanoni kodin QR.



Më pas diskutoni pyetjet.

- Banka e Ushqimit ndihmon kishat me ushqim, por ka nevojë edhe për vullnetarë. Shikoni informacionin në faqen e tyre të internetit
- Në javën e ardhshme, bëni njerëzit të mendojnë se cilët njerëz kanë nevojë për më shumë ndihmë.



13. Mbyllni takimin me një lutje. Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonit njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



Tema e katërt: Bëni drejtësi

Bëni drejtësi



1. **Mirëprisni** njerëzit dhe filloni me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.
2. Sot fokusi është tek shenja e katërt: “Ndryshimi i strukturave të padrejta”



Shpallja e lajmit të mirë



Pagëzimi dhe rritja e besimtarëve të rinj



Përgjigje ndaj nevojës përmes shërbimit



Ndryshimi i strukturave të padrejta



Kujdesi për krijimin



3. **Lexoni “Hyrje”, faqe 28**
Në shoqërinë tonë të Shqipërisë dhe Kosovës ka shumë padrejtësi, korrupsion, etj. Si të krishterë jemi thirrur të bëjmë drejtësi. Ne do të flasim për këtë në këtë takim.



4. **Lexoni Biblën Isaia 58:1-11**

5. **Lexoni “Lutuni sinqerisht”, faqe 30**

Këtu flitet për t'i shërbyer Perëndisë. Në kohën e Isaisë kishte shumë që nuk e bënë këtë nga zemra. Ata agjëronin por nuk kujdeseshin për ata që kishin nevojë.





6. Diskutoni pyetjen 1, faqja 31

Në Isaia 58:1-11, Profeti Isaia flet për një kritikë të ashpër ndaj popullit të Izraelit për hipokrizinë e tyre në praktikimin e adhurimit. Ata dukej që ndiqnin rregullat fetare, por në të vërtetë zemra e tyre ishte larguar nga Perëndia. Isaia kërkon që ata të kuptojnë se adhurimi i vërtetë kërkon më shumë se thjesht rituale dhe praktika të jashtme. Zoti vlerëson sjelljen e tyre ndaj njeriut, veçanërisht nevojtarëve në shoqëri. Zoti dëshiron një adhurim të ndershmëm dhe një jetë të përfshirë me drejtësi dhe dashuri ndaj të tjerëve, duke shprehur kështu vullnetin e tij. Ai i fton ata që të ndryshojnë rrugët e tyre dhe të ndjekin rregullat dhe udhëzimet e tij me zemër të pastër dhe dashuri për të tjerët.

7. Lexoni “Të jetosh me ndershmëri” në faqen 31

Zoti kujdeset gjithmonë për zemrat tona. Kjo vlen edhe, për shembull, kur bëhet fjalë për agjërimitin. Agjërimi i vërtetë përfshin akte drejtësie dhe mbrojtje për ata që janë të dobët.

Zoti e urren padrejtësinë



8. Diskutoni pyetjen 2

- a. Kjo pyetje mund të diskutohet edhe në grupe të vogla. Ndonjëherë flasim për dashuri dhe solidaritet, por në kisha ka një atmosferë mosbesimi, xhelozie apo krenarie. Ndonjëherë gjërat ndodhin jo aq nga dashuria, por për shfaqje.
- b. Një arsye pse Perëndia qëndron larg kishës sonë mund të jetë se Ai (ashtu si me izraelitët) beson se ne nuk po i shërbejmë Atij me zemër. Është e dhimbshme të kuptosh se në disa raste ne vetë shkaktojmë mungesën e Zotit.



- c. Pendimi, lutja dhe agjërimi janë gjithmonë të mira. Por sidomos kur shohim disa tendenca të gabuara në kishë. A ka njerëz që kanë përvojë me një ditë të tillë pendimi në një kishë?



9. Lexoni “Politika?” faqe 33

Shpesh mendojmë se besimi është kryesisht diçka që ka pak të bëjë me jetën e përditshme. Ose kemi frikë se si besimtarë do të merremi shumë me politikën. Por në mbretërinë e Perëndisë është gjithashtu e rëndësishme që të ngrihemi për lirinë dhe paqen.



10. Diskutoni pyetjen 3

Ndonjëherë kishat kanë kontakte me bashki apo organizata të tjera

- A kanë njerëzit shembuj për këtë? Cilat janë përvojat? Nëse nuk ka ende kontakte me bashkin, si mund ta nisim atë?
- Çfarë mund të bëjmë më shumë për të luftuar padrejtësinë? Mundohuni të jeni sa më specifik.

11. Lexoni “Një premtim” në faqen 34

Nëse jetojmë me një sy drejt drejtësisë, atëherë mund të jemi të sigurt për premtimet e Perëndisë. Ai do të jetë me ne, drita dhe burimi ynë.



12. Diskutoni pyetjen 4

Këtu po flasim për të gjitha llojet e premtimeve që Perëndia bën në Isaia 58:8-11.

- Cili premtim është më tërheqës?
- Gjithashtu le të flasim nëse dinë premtime të tjera nga Bibla.



13. Ndarja e tregimeve

Shikoni videon për "Skllavërinë moderne". Shikoni lidhjen

<https://youtu.be/IUtNiX0ICjk>

ose skanoni kodin QR. Më pas diskutoni pyetjet.

- Lëri t'ju tregojnë se çfarë panë dhe çfarë i preku.
- A njohin ata njerëz që janë viktimë të "skllavërisë moderne" të shfrytëzimit, punës së fëmijëve, trafikimit seksual, etj.?
- Ne mund t'u tregojmë atyre se jemi në anën e tyre dhe kujdesemi për ta. Mund të tërheqim vëmendjen ndaj situatave të padrejta në shoqëri ose midis politikanëve duke votuar, apo duke shkruar letra proteste etj.
- Perëndia nuk shqetësohet vetëm për besimin tonë, por edhe për veprimet tona të drejtësisë. Këto dy gjëra janë të lidhura.



Mikea 6:8

O njeri, Ai të ka bërë të njohur atë që është e mirë; dhe çfarë tjetër kërkon Zoti nga ti, përveç se të zbatosh drejtësinë, të duash mëshirën dhe të ecësh përlësisht me Perëndinë tënd?

- Lutja.** Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonit njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



Ndarja e tregimeve



lutje

Tema e pestë: Kujdesuni për krijimin

Kujdesuni për krijimin



1. **Mirëprisni njerëzit dhe filloni me një lutje** ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Ndarja e tregimeve**

Lexoni pyetjen dhe diskutoni me njëri-tjetrin

- Cilët elementë të krijimit ju pëlqejnë më shumë?
- Çfarë ju shqetëson kur mendoni për krijimin e Zotit (Ndotja, mbarimi i burimeve, etj.)

3. Sot fokusi është tek shenja e pestë: “Kujdesi për krijimin”



Shpallja e lajmit të mirë



Pagëzimi dhe rritja e besimtarëve të rinj



Përgjigje ndaj nevojës përmes shërbimit



Ndryshimi i strukturave të padrejta



Kujdesi për krijimin



4. **Lexoni “Hyrje” në faqen 38**

Zoti e bëri të përsosur krijimin. Fatkeqësisht, krijimi u ndikua edhe nga Rënia. Këtë do ta diskutojmë me njëri-tjetrin në këtë takim.



5. **Lexoni Bibën, Romakëve 8:18-28**



Romakëve 8:18 ALB

Unë mendoj në fakt, se vuajtjet e kohës së tanishme nuk vlejnë aspak të krahasohen me lavdinë që do të shfaqet në ne.

© FOKUSI, www.fokusi.al



FOKUSI – Seri F



6. Diskutoni pyetjen 1


a. Pali thotë se:

- krijimi është në vuajtje dhe dëshiron kohën kur do të bëhet e qartë se cilët janë fëmijët e Zotit
- krijimi i nënshtrohet vdekjes dhe kalbjes
- krijimi do të çlirohet nga fuqia e vdekjes dhe e kalbjes.
- krijimi do të marrë të njëjtën lavdi si fëmijët e Perëndisë.
- krijimi tani po pret atë moment madhështor
- krijimi ende psherëtin dhe rënkon si një grua që duhet të lindë

b. Ftojini t'i përgjigjen gjërave që Pali thotë për krijimin.

7. Lexoni "Krijimi në Bibël" në faqen 40

Zoti e bëri botën të mirë. Ai caktoi njerëzit që të kujdeseshin për krijimin. Në shumë raste, njeriu nuk e ka bërë këtë siç duhet, që do të thotë se krijimi tani nuk është më i mirë.



8. Lexoni "Gjashtë ditët e krijimit"

Pyetni njerëzit nëse e dinë se çfarë u krijua në ditën e parë, të dytë, etj. Ata tashmë mund ta lexojnë dhe ta shohin atë në librin e tyre. Zoti krijoi gjithçka në gjashtë ditë dhe pushoi në ditën e shtatë.

9. Lexoni "Vuajmë së bashku", faqe 41

Krijimi është duke vuajtur, por edhe njerëzimi, sepse krijimi tani është i dëmtuar. Por do të vijë koha kur krijimi do të përtërihet.



10. Lexoni “Shkak brenda nesh”, faqe 42

Kërkon një qëndrim në ndryshim për t'u kujdesur më mirë për krijimin. Bëhet fjalë për konvertimin. Jemi bërë shumë “bosë” të krijimit, kur duhet të jemi shërbëtorë të krijimit. Vetëm nëse e trajtojmë krijimin me kujdes, ai mund të mbajë jetën.



11. Diskutoni pyetjen 2 në faqen 42

- Si kishë apo si person ndoshta mund të bëni më shumë për ndarjen e mbetjeve (plastikë, letër, veshje), nëse kjo është e ndarë edhe në qytet/fshat. Mund të përpiqeni të mos hidhni plehra në rrugë. Ju mund të konsideroni nëse ka mënyra për të përdorur më pak plastikë (p.sh. pa qese plastike) etj.
- Teoria e Darvinit është vendimtare në shoqërinë shqiptare dhe në sistemin shkollor. Të gjithë shqiptarët e kanë mësuar, por Bibla na mëson se ka një Zot që ka krijuar tokën. Si mund të flisni me njerëzit për të? Psalmi 139 thotë se Zoti e njeh jetën tonë ditë pas dite, madje edhe para lindjes.
- Ata të gjithë kanë një histori krijimi që është e ngjashme me historinë biblike të Adamit dhe Evës. Ka dallime në detaje. Kush mund të thotë diçka për këtë (një ish-bektashi, ish-mysliman, ish-ortodoks apo ish-katolik?)



12. Ndarja e tregimeve

Shihni videon rreth Koos dhe diskutoni pyetjet
Shikoni lidhjen <https://youtu.be/bw1NAMt01bc>
ose skanoni kodin QR

- Ftojini njerëzit t'i përgjigjen fjalëve të Koos.
- Ftojini njerëzit të përgjigjen. A janë ata mjaft seriozë në mbrojtjen e krijimit të Zotit?



13. Lexoni “Çlirimi i fëmijëve të Zotit dhe i krijimit



14. Diskutoni pyetjen 3 në faqen 44

- Ftojini njerëzit të mendojnë se si ka ndryshuar krijimi para dhe pas Rënies. Çfarë ishte e mirë më parë dhe çfarë nuk ishte më e mirë pas Rënies? Cilat janë pasojat (sëmundjet, vdekjet, përmytjet, fatkeqësitë, tërmetet, ndotja, etj.)
- Si e imagjinojnë njerëzit krijimin e ri? Shih p.sh. 2 Korintasve 5:17, Isaia 65:17, Isaia 66:22, Zbulesa 21:4, Isaia 65:17-25, Isaia 66:22-23, 2 Pjetri 3:7-13, Zbulesa 21:1 -8



Zbulesa 21: 1

Dhe pashë një qiell të ri dhe një dhe të ri; sepse qielli i parë dhe dheu i parë kishin shkuar.



15. Në lëvizje

Lexoni tekstin nën “Në lëvizje” dhe përpquni të ndiqni disa nga këto këshilla në javën e ardhshme. Pyesni nëse njerëzit e kuptojnë detyrën dhe në çfarë duan të fokusohen kryesisht.



16. Mbylleni takimin me një lutje.

Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonti njërit prej pjesëmarrësve të lutet.





FOKUSI
Albania - Kosova



www.fokusi.al



Fokusi



info@fokusi.al



0697013501